REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 853, 855/20
Datë/Datum. 02.11.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Lavdim Fejza-eks.Teknik	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	Nr. i lëndës:
	27.10.2020	02.11.2020	853-855/20

Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën :23.10.2020, 23.10.2020, OE **"DWH Kosova"shpk-** Prishtinë, **"DWH Albania"shpk-** Shqiperi , ka parashtruar ankesë me nr: 853-855/20, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Pajisje të Gjeodozisë - Kontrollera"**,me nr. të prokurimit: 318-20-3654-1-2-1 , iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMISIONI I PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: **13.000,00 Euro**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Dispozitat e shkelura dhe pretendimet ankimore- OE **"DWH Kosova"shpk-** Prishtinë, , **"DWH Albania"shpk-** Shqiperi

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik në pajtim me Nenin 87, paragrafin 2, nën paragrafin 2.8 dhe nenin 118, paragrafi 1, të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L- 092, adopton Rregullat qe plotësojnë dhe japin sqarime për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese dhe parashtrim te ankesave pranë OSHPse si dhe përcakton vlerën e tarifave për parashtrim te ankesës pranë OSHP-se.

DETAJE dhe FAKTE

AK kerkon te bleje produkt te ri, per pjese te mbetura te nje produkti te vjeter. Por ligja parasheh per raste te tilla "blerjen nje burimore". AK, duke e ditur qe Ministria e Finances nuk do e pranoje, qe te shpenzohen shuma te pajustifikueshme per nje produkt te vjeter, te tejkaluar dhe per te cilin jane bere shpenzime te here-pas-hershme per riparim, ka vendosur ta "luaje" me ligjin. Pra te ndjeke proceduren e "blerjes se hapur", por duke paracaktuar

produktin, cka bie ndesh me vehet LPP.

Ku ska gare, nuk ka tender, sepse nese ti paracakton produktin, si mund te realizohet gara?!

OSHP me te drejte e ka praspuar dy here AK, e cila vazhdon me kokfortesi, duke mos respektuar vec ligjit edhe dy vendime te OSHP, e cila per cudi nuk merr masa kunder AK, edhe pse ne vendimet e OSHP, parashihet masa ligjore nese nuk respektohen vendimet e OSHP.

Por AK ne ndjekje te qellimit te saj, arrin te beje nje shkelje flagrante te LPP, nuk reagon fare ndaj kerkeses per rishqyrtim te OE, DWH - KOSOVA shpk.

Ligji parasheh qe brenda tre diteve nga kerkesa per rishqyrtim AK, duhet te ktheje pergjigje.

Nje shkelje te tille te te drejtave te OE, ligji e denon qarte dhe pa ekuivok "me heqjen e licences se punonjesit pergjgjes te prokurimit".

Ky fakt, pas dy rrezimeve per te njejtin tender nga OSHP, tregon qarte se individ te caktuar te AK, ndjekin nje agende te ndryshme me agenden e interesave te entit publik KPMM.

Nr.		Kerkesa 14.07.2020	Kerkesa 14.09.2020	Kerkesa 19.10.2020	Ne baze te LPP
1		GRX1 SCH25A	GRX1 SCH25A	GRX1 SCH25A	duhet hequr
2		SIM-Karta duhet vendoset ne marres GPS (GRX1). ul rendimentin e punës sepse GPS nieh vetëm internet 2q (EDGEK	SIM-Karta duhet vendoset ne marres GPS (GRX1), ul rendimentin e punës sepse GPS nieh vetem internet 2q (EDGE)!	Terminali duhet te ketë te inteqruar modemin SIM (qe te leioi qasie me te lehet dhe me te shpeit ne internet)	konform
3		Kentrolloret SHC25A duhet te kenë porte SIM te inteqruar, dhe për ketë arsye qe rendimenti te iete me 1 larte rekomandohet qe ndrvshimi	Kontrollerat SHC25A duhet te kenë porte SIM te inteqruar, dhe për ketë arsve qe rendimenti te jete me 1 larte rekomandohet qe ndrvshimi te	Te këtë mundësi konketimi Bluetooth, Wifi	konform

			te behet me tastier qe ka mundësi portin GSM, ku lidhia te behet me shpeitësinë e	behet me tastier qe ka mundësi portin GSM, ku lidhja te behet me shpejtësinë e fundit 3-4G			
	4		Ekranet e tastierave te reja duhet kanë shikueshmëri shume me te larte, dhe iane	Ekranet e tastierave te reja duhet kanë shikueshmëri shume me te larte, dhe iane	Te jete touchscreen	konform	
			shume me te lehta ne përdorim ne	shume me te lehta ne përdorim ne dite			
			dite me ndriçim te larte	me ndriçim te larte			
	5		Nqarkimi shkarkimi i punëve duhet behet me USB	Nqarkimi shkarkimi i punëve duhet behet me USB	T e këtë	Memorie e brendshme	
					memorie për	64GB eshte e pazakonte	
			ne tastierat e reja dhe ianë shume me fleksibel	ne tastierat e reia dhe iane shume me fleksibel	ruaitën e te dhënave io me	ne kontroller. AK duhet te treqoie	
					pak se 64GB	burimin ku e ka qietur	
	6		Te kane	Te kane	Te iete me sistem operativ	Sitsem operative ka me	
			memorie me	memorie me te	Windows 7, 8	shume se windows, te	
			te larte	larte	ose 10, për	hapet edhe per sisteme	
					ndërveprim me	ekuivalente si Android,	
					te lehet mes paiisies dhe	IOS eti	
					PC-ve qe		
					posedon AK-se		
	7		Te kane	Te kane	Nqarkimi	e paqarte, e	
					shkarkimi i		
					punëve duhet		
			procesor me	procesor me te	behet te iete		
			te shpejt	shpeit	me USB Te	padefinueshme.	
					kane memorie		

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE **"DWH Kosova"shpk-** Prishtinë, - **"DWH Albania"shpk- Shqiperi** ka parashtruar ankesë me nr:853-855/20, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Pajisje të Gjeodozisë - Kontrollera"**,me nr. të prokurimit: 318-20-3654-1-2-1 , iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMISIONI I PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE.

				me te larte	
8		Softueri i ri duhet te iete shume me I thieshtë dhe me mundësi me te me te mëdha ne përpunim	Softueri i ri duhet te iete shume me i thjeshtë dhe me mundësi me te mëdha ne përpunim	Softueri i ri qe do te viie me pajisiet e reia, duhet te ketë softuer qjeodezik për terren te instaluar ne te	Po vec kontroller, AK kerkon ne menvre te fshehte edhe software baze? Edhe software aplikativ? Porfiala ishte qe kontrolleri nuk eshte shume mire. Tani dolen edhe dv ose me shume software?
9		Te ketë te inteqruar Map-in (binq-s map) për orientim me te lehet ne terren nëse iemi te saktë te sistemin koordinativ	Te këtë te inteqruar Map-in (binq-s map) për orientim me te lehet ne terren nëse iemi te saktë te sistemin koordinativ	Softueri duhet te përkrah GPS-in ekzistues (pra te mundësoi lidhien me te), dhe te përkrah formatin DWG	te leioie produkt te ri te plote me te njejtin buxhet.

Konkluzion: AK shfrytezon faktin qe nga produkti i vjeter, po blen te gjithe produktin me perjashtim te nje antene te jashtme (teneqe petashuqe), e cila ne vetvehte nuk ka inteligjence, por vetem tenqen perforcuese te valeve.

Ajo qe AK po kerkon te bleje nen emrin "KONTROLLER" permban:

1. Antenen e brendshme
2. Software baze (firmware)
3. Software aplikativ (sw pune), dhe
4. Kontroller.

Pra eshte GPS i plote dhe keshtu sic eshte ben matje pa kerkuar asgje me shume, por AK e kamuflon nen emrin e pjesshem Kontroller.

Fakti qe ka edhe nje antene te jashtme eshte sepse kualiteti i GPS eshte shume i dobet dhe mat me shkalle te madhe gabimi (prej cilesise se dobet) dhe i vendosin edhe nje antene teneqeje te jashtme qe te forcoje sinjalin.

Buxheti prej 13.000€ do mjaftonte per te blere nje produkt te ri, te plote, aktual, me performance, funksionalitet dhe specifikime teknike shume me te larta se ky produkt I tejkaluar.

Perse AK vendos te shkoje drejt se shkuares me buxhet te 2020 eshte "pakuptueshme"?!

Ne i kerkojme OSHP:

1. Te zbatoje ligjin per rastin kur AK nuk i pergjigjet ne kohe kerkeses per rishqyrtim te OE.

2. Te rrezoje kerkesen e AK, duke i kerkuar asaj te hape garen, si e parasheh LPP per blerje me tender, ne baze te kollones 4.

Dispozitat e shkelura dhe pretendimet ankimore- OE "DWH Albania"shpk- Shqiperi

Ligji i prokurimeve publike 04/L-042, i ndryshuar dhe perplotesuar me ligjet 04/L-237,

05/L-068 dhe 05/L-92

Neni 1, P.1, 2 dhe 3

Neni 7, P.1,3,4 dhe 6

Neni 9.1

Neni 28, P.1 - 9.

AK hap proceduren "blerje me tender", por ne fakt ndjek poceduren "blerje nje burimore".

AK ne kerkesen e tij jep

- tipin dhe modelin produktit GRX1 SCH25A
- emrin e prodhuesit, dhe
- definion edhe OE.

Per ta bere te qarte kete japim nje shembull nga gara per punesim te nje specialis ne nje ent publik:

- emrin e personit (Pelivan)
- mbiemrin e personit (Lukunia)
- datelindjen e personit, (01.04.2000)
- vendbanimin e personit (Rr. Perfitimi, Fushekosove)
- emri nenes (Sheqere Lukunia)
- emri babes (Garip Lukunia)

Sa persona do paraqiten ne gare: 1

Kush do shpallet fitues: Pelivan Sheqere Garip Lukunia.

Po a e lejon LPP 04/L-042, Neni 1, Pika 1, 2 dhe 3, po Neni 7, Pika 1, 3, 4 dhe 6, po

Neni 9, pika 1, po Neni 28, Pika 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9?

AK	Kerkon Refuzon
Produkt te pjesshem (kontroller)	Produkt te plote (komplet GNSS)
Produkt te tejkaluar (te para 10-15 viteve)	Produkt aktual 2020
Produkt me specifikime teknike te dobeta	Produkt me specifikime teknike aktuale

Te bleje me 13000€ nje pjese te produktit	Por jo te gjithe produktin me 13000€

Konkluzion: AK kerkon te bleje pjese te automobilit (se rrotat i ka), por refuzon te bleje automobil te ri me te njejtin cmim.

LPP e detyron AK te bleje me efikasitet, ne menyre ekonomike, me transparence dhe ne menyre te drejte.

Por AK nuk ndjehet mire brenda ligjit, dhe kerkon te bleje nje produkt te lire me kater here me shtrenjte se vlera e tij ne treg.

Aresyeja perse AK nuk repsekton ligjin dhe perse blen me shtrenjte se sa eshte vlera e produktit, jane organe te tjera qe merren me kete pune.

AK nuk tregon burimin e informacioneve te produktit qe kerkon, pasi produkti me emertimin GRX1 nuk eshte me ne treg. Cfare metode ka ndjekur AK per te perfituar kete produkt, qe ka dale prej vitesh nga prodhimi?

A eshte nje produkt jashte prodhimit ne perputhje me LPP?

Ne attachment "evolimi i AK ne tenderin e pare, te dyte dhe te trete", tregin qarte se si AK pasi eshte rrezuar dy here nga OSHP, heren e trete e ben kerkesen 100% me te dhenat e kontrollerit te Sokkia.

Bile nuk kerkon vetem kontroller, por si edhe shihet tani kerkon edhe Software, te cilin ne dy kerkesat e para nuk e permendte fare. Tani kerkon Kontroller, Software.

Pyetja eshte po Antene te brendshme duhet te kete kontrolleri?

Jo vetem kaq por kur ne i dergojme AK pyetje, AK na pergjigjet me vendim-refuzimin e kerkeses per Rishqyrtim, qe ne nuk e kishim bere akoma, sepse AK i merr masat

perpara, nuk pret qe ne te dergojme Kerkese per Rishqyrtim, e dergon pergjigjen te parapregatitur (s. vendimin e AK 21.10.2020).

Date 19.10.2020 hapja e tenderit

Date 19.10.2020 ne bejme pyetje shtese

Date 20.10.2020 (mos)pergjigja e pyetjeve te bera nga ne

Date 20.10.2020 i ribejme pyetjet (pasi nuk jane pergjigjur per pyetjet tona por per gjera pa lidhje)

Date 21.10.2020 Vendim-refuzim i kerkeses per rishqyrtim, kur ne nuk kishim

bere akoma kerkese per rishqyrtim (edhe pse ne nuk kishim bere ende nje kerkese

per rishqyrtim)

Date 21.10.2020 Kerkese per rishqyrtim

Date 22.10.2020 Vendim-Refuzim i kerkeses per rishqyrtim.

Ne, i kerkojme OSHP, qe te prapsoje vendimin e AK, dhe ta detyroje ate:

1. te hape specifikime teknike, konform LPP 04/L-042, Neni 1, Neni 7 dhe Neni 28, ku ne cdo specifikim te shenohet edhe ekuivalent.

2. te heqe te gjitha emertimet qe te cojne te nje produkt dhe nje prodhues te vetem

3. te hape specifikime teknike edhe per produkte te tjera, jo vetem per sokkia-topcon.

3. te lejoje qe OE, nese eshte e mundur, te ofrojne te tere produktin (GPS) dhe jo vetem pjese te tij (kontrollera), brenda fondit te tenderit, cka rrit vleren e investimit per te njejtin buxhet.

Kriteret për vlerësim

Aneksi 1- Specifikimi teknike te detyrushme

Raporti i komisionit vlerësues

N/A

Informacionet shtesë të marra me anë të sqarimeve të kërkuara nga ana e ekspertëve shqyrtues dhe /ose teknik

N/A

Vlerësimi sipas nenit 4.1.26 tëLPP-së

N/A

Vendimet e mëparshmetë PSH-së,lidhur me rastet e ngjashme

(Të sqarohet nësepër rastin e njëjtë është dhënë vlerësim tjetër).

Arsyetimi për devijim nga praktika e mëparshme

N/A

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE **"DWH Kosova"shpk-** Prishtinë

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Ekspert shqyrtues / teknik *sqarone se Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale-KPMM, me datën: 19.10.2020 ka korrigjuar dosjen e tenderit përmes formularit standard për korrigjim te gabimeve sipas vendimit te OSHP- se te datës: 14.10.2020 Nr.prot 677/20 për aktivitetin e prokurimit "Pajisje te Gjeodezise - Kontrollera " me numër të prokurimit:* ***318-20-3654-1-2-1,*** *përmes procedurës se hapur ne harmoni me Ligjin për Prokurimin Publik te Republikës se Kosovës Nr.04/L-042, I ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237. Ligji Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.*

Po ashtu, Autoriteti Kontraktues me marrjen e vendimit te OSHP-se te datës: 14.10.2020 dhe ekspertizën e ekspertit shqyrtues ne bashkëpunim me njësinë ka bërë ndryshimet e nevojshme ne specifikacionet teknike duke ngritur ne E-prokurim "Dosje te tenderit-korrigjuar", mirëpo ne fund ka ardhur ne përfundim se këto janë nevojat e AK-KPMM për ketë blerje dhe si rrjedhojë këto specifika janë bërë pjesë e dosjes se tenderit.

Autoriteti Kontraktues ka veprua ne harmoni me Vendimin e OSHP-se 677/20 te dt 14.10.2020 siç është cekur edhe ne arsyetim te vendimit:

Bazuar ne vendimin e OSHP-te dates 14.10.2020 nr 677/20 saktesisht ne fq 6 te raportit panelli shqyrtues ka sygjeruar AK-KPMM qe te blihen kontroller te ri pra sipas vendimit te panellit shqyrtues leverdia është te blihen kontroller te ri, referoju vendimit te panellit si me poshtë:

> përbërëse siç shihet në foton e bashkangjitur në raportin e ekspertit shqyrtues/teknik. Paneli Shqyrtues konform ekspertit teknik sqaron se gjatë hulumtimit të bërë për pajisjen në fjalë, i sugjeron Ak-në se me shumë do të ishte e leverdishme të bëjë furnizimin me kontroller të ri se sa të bëjë servisimin e kontrollerëve të vjetër (ekzistues) pasi ky kontroller është model i viti 2010. Pra, leverdia është të furnizohet me kontroller të ri duke parë avancimin e teknologjisë së kësaj lëmie, ku shkalla e gabimeve në matje është me e vogël në krahasim me kontrolloret ekzistues. Prandaj, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik obligon AK-në që të përpilojë specifikime teknike sipas nevojave të tyre dhe të definoj saktësisht se për çfarë produkte bëhet fjale, në mënyre që të kenë qasje të barabartë të gjithë OE të interesuar dhe tenderuesit që të ofrojnë zgjidhjen e tyre.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues është e pa bazuar, të mbete ne fuqi vendim i autoriteti kontraktues njoftimi për Kontratë .

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KPMM**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP-se.**
- OE ankues - **"DWH Kosova"shpk-** Prishtinë
  - **"DWH Albania"shpk-** Shqiperi

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE **"DWH Kosova"shpk-** Prishtinë, - **"DWH Albania"shpk- Shqiperi** ka parashtruar ankesë me nr:853-855/20, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Pajisje të Gjeodozisë - Kontrollera"**,me nr. të prokurimit: 318-20-3654-1-2-1 , iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMISIONI I PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE.